



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:136411
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05296015

CAP.nr.960/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit K.R.M., “Ç.....”, sh.a., në Gjakovë, ndaj debitorit Xh.Sh., nga Gjakova, Rr. “S.....”, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e palës së interesuar, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.187/21 të datës 31.05.2023, me datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e palës së interesuar M.K.Sh., nga Gjakova, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.187/21 i datës 31.05.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.187/21 të datës 31.05.2023, ka hedh poshtë si të palejuar prapësimin e paraqitur nga M.K.Sh., i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.337/21 të datës 27.05.2021, i lejuar nga zyra përmbartimore e përmbartuesit privat Gj.R., për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë pala e interesuar, për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën si të bazuar, të ndryshoj aktvendimin e atakuar apo lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për bartjen e mbeturinave nr.XXXX, lidhur me borxhin në vlerë prej 513.95 euro, për periudhën nga data 30.11.2009 e deri me datën 30.04.2021. Përbaruesi privat, ka lejuar përbarimin e kërkuar me urdhrin përbarimor P.nr.XXX/21 të datës 27.05.2021, kundër këtij urdhri pala e interesuar ka ushtruar prapësim me datë 21.06.2021. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë konkluzionin PPP.nr.187/21 të datës 04.04.2023, me të cilin ka ftuar palën e interesuar që në afat prej 3 ditësh t'i dorëzoj gjykatës certifikatën e vdekjes së debitorit Xh.Sh., me njoftimin për pasojat ligjore. Pala e interesuar, përkundër pranimit të konkluzionit nuk ka vepruar brenda afatit të caktuar. Gjykata, pas kalimit të afatit sipas konkluzionit, vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimin, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallë së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i çartë, prandaj vendimin e gjykatës së shkallë së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, drejtë është vërtetuar gjendja faktike kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vepruar kur ka hedhur poshtë si të palejuar prapësimin e ushtruar në llogari të debitorit ndaj urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.337/21 të datës 27.05.2021, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 179, paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: *“Në qoftë se ankesa nuk i përmban elementet nga neni 178 i këtij ligji (ankesa jo e plotë), gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit, kundër të cilit nuk lejohet ankimi, e thërret ankuesin që brenda afatit prej shtatë ditësh ta plotësojë ankesën e paraqitur”*. Ndërsa duke u bazuar në dispozitën e nenit 186, paragrafi 1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedh poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”*. Në rastin konkret, gjykata me konkluzionin PPP.nr.187/21 të datës 04.04.2023, ka detyruar palën e interesuar që në afat prej 3 ditësh, të dorëzoj certifikatën e vdekjes për debitorin. Përkundër faktit se pala konkluzion e ka pranuar, e njëjta nuk ka vepruar sipas këtij konkluzioni.

Duke u mbështetur në paragrafin 3, të nenit 186 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”*. Në rastin konkret, kjo Gjykatë vlerëson se prapësimi i cili në procedurën përbarimore është mjet i rregullt juridik i goditjes, i paraqitur nga M.K.Sh., në emër të debitorit Xh.Sh., është i pa

lejuar, pasi që e njëjta nuk është e autorizuar për të ndërmarr veprime në këtë çështje përmbartimore dhe se gjykatës nuk i ka dorëzuar si provë certifikatën e vdekjes për debitorin në mënyrë që e njëjta të mund të caktohet si përfaqësuese e përkohshme.

Lidhur me pretendimet ankimore sa i përket vdekjes së debitorit si dhe parashkrimit absolut të borxhit, Gjykata ankimore vlerëson se këto pretendime tani për tani nuk mund të shqyrtohen, pasi që në rastin konkret kjo Gjykatë e shqyrton vetëm aktvendimin e atakuar dhe bazën ligjore mbi të cilën është nxjerrë ky aktvendim, dhe se pretendimet e tilla është dashur që të vlerësohen nga gjykata e shkallës së parë, mirëpo meqë në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se prapësimi është i palejuar, atëherë e njëjta nuk është lëshuar në vlerësimin e këtyre pretendimeve. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata e Apelit vlerësoj se duhet refuzuar si të pathemeltë ankesa e palës së interesuar dhe të vërtetoj aktvendimin e atakuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CAP.nr.960/2023, me datë 07.02.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti